

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza

Titulli: Forcimi i Integritetit Gjyqësor dhe Përmirësimi i Aksesit në Drejtësi për të Mbijetuarit e Dhunës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Qëllimi: Rritja e transparencës dhe integritetit të sistemit gjyqësor në Shqipëri, me fokus të veçantë tek çështjet e dhunës në familje.

Kohëzgjatja: Ky projekt 9 mujor i cili po zbatohet nga Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza.

Nëpërmjet monitorimit sistematik të proceseve gjyqësore, angazhimit të organizatave të shoqërisë civile, studentëve të drejtësisë, gazetarëve dhe institucioneve publike, projekti do të kontribuojë në rritjen e llogaridhënies dhe përmirësimin e aksesit në drejtësi për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës.

Duke analizuar vonesat dhe mangësitë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, projekti do të zhvillojë raporte të bazuara në të dhëna dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e standardeve të gjyqimit dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes për viktimat.

Përmes workshop-eve me aktorë kyç dhe fushatave të ndërgjegjësimit, synohet të rritet angazhimi qytetar dhe të nxitet një kulturë e drejtësisë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Ky projekt synon që në afatgjatë të krijojë një model të replikueshëm të monitorimit gjyqësor, të rrisë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe të nxisë reforma të qëndrueshme për të garantuar një proces gjyqësor më të drejtë dhe më të ndjeshëm ndaj nevojave të viktimave të dhunës.